



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar për auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit ushtruar
në Agjencinë Kombëtare të Diasporës**

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

PËR

SISTEMET E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

NË

AGJENCINË KOMBËTARE TË DIASPORËS

Tiranë, dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm i Auditimit	4
II.	HYRJA	
1.	Objektivat dhe qëllimi	5
2.	Identifikimi i çështjes	5
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	6
4.	Përgjegjësitë e audituesve	6
5.	Kriteret e vlerësimit	6
6.	Standardet e auditimit	7
7.	Metodat e auditimit	7
8.	Dokumentimi i auditimit	7
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	Verifikimi i masave rregullative për teknologjinë e informacionit	8-13
2.2	Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input/Output	13-24
IV.	REKOMANDIME	25-28

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin mbi Teknologjinë e Informacionit në Agjencinë Kombëtare të Diasporës, nga data 03.07.2025 deri në 30.07.2025.

Grupi i auditimit, pasi mblodhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë mbi të cilat hartoi drejtimet e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në Agjencinë Kombëtare të Diasporës, është pjesë e Planit Vjetor të auditimit për vitin 2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-s.

Përzgjedhja e këtij subjekti është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH ka vlerësuar të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që ka në përdorim Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 585/1, me datë 30.06.2025 dhe në terren përfundoi brenda afatit të përcaktuar në program.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Agjencia Kombëtare e Diasporës administron një bazë të dhënash, në zbatim të VKM nr. 504, datë 24.6.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”.

Sipas përcaktimit në pikën 1 në VKM-së së sipërcituar, kjo bazë të dhënash, përmban të dhëna personale për:

a. shtetasit shqiptarë, të cilët kryejnë studimet universitare jashtë vendit;

b. shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë;

c. shtetasit shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit të cilat i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë.

Gjithashtu në VKM-në e sipërcituar, në pikën 6 përcaktohet se dhënës të informacionit për bazën e të dhënave shtetërore, janë ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punët e jashtme. Të dhënat që janë përcjellë tek Agjencia Kombëtare e Diasporës, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në rrugë shkresore dhe elektronike në formatin Excel, për studentët ekselentë, janë të dhënat që krijohen në zbatim të VKM nr.160, datë 19.2.2020 “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”. MAS administron procedurën e pranimit të aplikimeve, regjistrimit, verifikimit, menaxhimit të bursave të studimit, si dhe detyrimet për financimin e studimeve universitare kryer jashtë vendit, si dhe shtetasit shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit që i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë.

Nga auditimi i listës së programeve të financimit në sistemin informatik, u konstatua se që prej termave teknike të hartuar në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së

Informacionit, nuk është përcaktuar kategorizimi i të dhënave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë, kërkuar në pikën 2.b të VKM-së nr. 504, datë 24.06.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”.

Nga verifikimet në sistem u konstatua se, kategoria për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe kategoria për të arsimuarit jashtë vendit me vetëfinancim, nuk janë krijuar si kategori në sistem, në kundërshtim me aktin ligjor në të cilin është ndërtuar sistemi që është VKM nr. 504, datë 24.06.2020. Gjithashtu, për periudhën objekt auditimi nuk u evidentua asnjë kërkesë nga institucione të jashtme për të aksesuar bazën e të dhënave, çka tregon për mungesë përdorimi dhe vlerësimi në praktik të këtij sistemi.

Në lidhje me sa më sipër, Agjencia Kombëtare e Diasporës që prej ndërtimit të këtij sistemi, ku përfshihet dhe periudha objekt auditimi, ka administruar një bazë të dhënash të populluar me të dhënat e aktivitetit të MASR sipas VKM nr. 160, datë 19.2.2020, duke krijuar mbivendosje funksionesh dhe paqartësi, për përgjegjësinë mbi administrimin e të dhënave personale të studentëve që kanë përfituar bursa jashtë vendit.

- Nga auditimi u konstatua mungesë e strukturës së re organizative dhe përmirësimi i rregullores së brendshme të institucionit referuar ndryshimeve ligjore, si elementë të domosdoshëm për funksionimin e tij. Kjo mangësi bie në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 120, datë 06.03.2024, e cila përcakton detyrimin për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, duke kërkuar përshtatjen e strukturës dhe rregullores së brendshme me ndryshimet institucionale dhe varësinë e re të institucionit.

- Nga auditimi u konstatua se, gjatë periudhës së objektit të auditimit dhe më parë, nuk është mundësuar vetë-deklarimi elektronik i të dhënave të diasporës përmes faqes zyrtare të internetit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës apo platformës së shërbimeve e-Albania. Ky vetë deklarim do të shërbente si një mjet i drejtpërdrejtë komunikimi për ndërtimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave, duke respektuar parimin e vullnetit të lirë të individit, në përputhje me pikën III.2.a të VKM nr. 120, datë 06.03.2024, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të marrin masat e nevojshme që ky sistem të administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të Republikës së Shqipërisë, me qëllim për të adresuar përgjegjësinë për të dhënat dhe përditësimin e tyre

- Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të marrin masat e nevojshme për miratimin e strukturës së re organizative, duke reflektuar ndryshimet institucionale dhe varësinë e re të institucionit. Gjithashtu, AKD të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme, ku të përcaktohet qartë funksionet dhe përgjegjësitë e secilës njësi sipas strukturës.

- Agjencia Kombëtare e Diasporës të marrë masa për të mundësuar vetë deklarimin elektronik për shtetasve shqiptarë të diasporës përmes faqes zyrtare web dhe të sigurohet për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim inkurajimin e shtetasve për përditësimin e të dhënave në mënyrë të lirë dhe vullnetare.

3. Konkluzioni i Përgjithshëm i Auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, ISSAI 5300, Udhëzime për auditimin e IT-së, ISSAI 5310, Metodologjia e Rishikimit të Sigurisë së Sistemit të Informacionit, si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, si dhe bazuar në procedurat e kryera dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, rezulton se institucioni është pjesë përbërëse e rrjetit qeveritar e-Gov dhe kontrollet IT zbatohen në nivel qendror nga struktura e AKSHI-t dedikuar për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Gjatë auditimit u identifikuan disa dobësi si rrjedhojë e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore në vitet e fundit që kanë të bëjnë me mungesën e strukturës organizative, mungesën e përmirësimit të rregullores së brendshme si dhe dokumentacionit teknik të sistemit që Agjencia administron në zbatim të VKM nr. 504, datë 24.6.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”.

Gjithashtu, auditimi i sistemit informatik dhe bazës së të dhënave shtetërore që administron Agjencia, konstatoi se është populluar vetëm me të dhënat e aktivitetit të MASR sipas VKM nr.160, datë 19.2.2020, duke krijuar mbivendosje funksionesh mbi administrimin e të dhënave personale të studentëve që kanë përfituar bursa jashtë vendit.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit nr. 585/1 Prot., datë 30.06.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 03.07.2025 deri më datë 30.07.2025, në Agjencinë Kombëtare të Diasporës, u krye auditimi mbi teknologjinë e informacionit, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. C., përgjegjëse grupi;
2. A. M., anëtare;
3. A. A., anëtar.

1. Objektivat dhe qëllimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në Agjencinë Kombëtare të Diasporës, nga data 03.07.2025 deri më datë 30.07.2025. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e Agjencisë Kombëtare të Diasporës arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e informacionit që gjenden në të.

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

2. Identifikimi i çështjes

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 585/1, me datë 30.06.2025:

1. Verifikimi i masave rregullative për teknologjinë e informacionit;
2. Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input/Output.

3. Përgjegjësitë e subjektit të audituar

Agjencia Kombëtare e Diasporës është një institucion buxhetor, aktualisht institucion varësie në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Agjencia Kombëtare e Diasporës (AKD) është institucioni shtetëror përgjegjës për krijimin, koordinimin dhe promovimin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe diasporës shqiptare. Ajo ka si qëllim kryesor fuqizimin e lidhjeve kulturore, ekonomike dhe sociale me qytetarët shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Roli i strategjik i Agjencisë Kombëtare të Diasporës është funksionimi si një urë lidhëse midis Shqipërisë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit, duke lehtësuar shkëmbimin ekonomik, kulturor dhe shoqëror dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi në vlerësimin objektiv dhe profesional e të pavarur, nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT në Agjencinë Kombëtare të Diasporës. Për këtë, nga grupi i auditimit me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 585/1 Prot., datë 30.06.2025 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit të teknologjisë së informacionit, si dhe legjislacionin e fushës në të cilën operon Agjencia Kombëtare e Diasporës. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret ligjore, rregullative dhe standardet mbi të cilat është mbështetur auditimi, janë si më poshtë:

- Ligjin nr. 16/2018 “Për Diasporën”;
- Ligji nr. 7/2024 “Për shfuqizimin e ligjit nr. 115/2017 “Për krijimin e agjencisë kombëtare të diasporës” të ndryshuar”;
- Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- VKM nr. 120, datë 06.03.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”;
- VKM nr. 945, datë 2.11.2012, “Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të Dhënave Shtetërore”;
- VKM nr. 504, datë 24.6.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”;
- VKM nr. 160, datë 19.2.2020 “Për Mbështetjen Financiare të Studentëve të Shkëlqyer dhe të Nëpunësve Civilë (Fondi I Ekselencës)”;
- VKM nr. 686, datë 02.09.2020 “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë Shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020-2021”;
- VKM nr. 447, datë 22.7.2021 “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë Shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022”;
- Struktura organizative miratuar me urdhrin nr.111, datë 10.09.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”;
- Rregullore e brendshme.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë dhe të qartë.

Standardet e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit që kanë shërbyer si kriter vlerësimi janë: ISSAI 5300, ISSAI 5310, ISO/IEC 27001:2022 dhe ISO/IEC 27002:2022.

7. Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit dhe sistemit informatik;
- Pyetësorë drejtuar institucionit;
- Intervista zhvilluar me personat përgjegjës.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, të dhëna dhe informacione të ndryshme të gjeneruara nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia Kombëtare e Diasporës e bazon aktivitetin e saj në Ligjin nr.16/2018 “Për Diasporën” dhe VKM nr.120, datë 06.03.2024, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Në përputhje me VKM nr. 120, datë 06.03.2024, detyrat funksionale të Agjencisë Kombëtare të Diasporës përfshijnë:

- përmirësimin e pozitës së diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të saj, aty ku gjendet;
- ofrimin e ndihmës për ruajtjen e gjuhës e të trashëgimisë kulturore kombëtare;
- nxitjen e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;
- bashkëpunimin për prosperitetin, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror të të gjithë kombit.

Bazuar në pikën 2 të VKM-së nr.120, datë 06.03.2024, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, për përmbushjen e misionit e të përgjegjësive funksionale të saj, Agjencia:

- a) merr masa për krijimin e bazës unike të të dhënave të diasporës, në bazë të vullnetit të lirë të personit. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;
- b) zbaton politika dhe projekte që lidhen me diasporën;
- c) ndjek zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës;
- ç) mban lidhjet ndërmjet diasporës, përfaqësuesve të saj dhe vendit të origjinës;
- d) bashkëpunon e koordinon aktivitetet me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e pozitës së diasporës në botë;
- dh) ndihmon për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, të vlerave kombëtare dhe kulturore të diasporës;
- e) informon diasporën për zhvillimet në vendin e origjinës, me qëllim përfshirjen e tyre në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë;
- ë) bashkëpunon me organizma vendas e ndërkombëtarë me fusha të ngjashme veprimtarie, me qëllim përthithjen e praktikave më të mira dhe krijimin e urave të bashkëpunimit.

2 Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Verifikimi i masave rregullative për teknologjinë e informacionit

Në zbatim të pikës 1 “Verifikimi i masave rregullative për teknologjinë e informacionit”, u shqyrtua, si më poshtë:

- Ligji nr. 16/2018 “Për diasporën”;
- Ligji nr. 7/2024 “Për shfuqizimin e ligjit nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” të ndryshuar”
- VKM-së nr. 120, datë 06.03.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”;
- Struktura organizative miratuar me urdhrin nr.111, datë 10.09.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”
- Rregullore e brendshme;
- Raport vjetor 2023 dhe Raport vjetor 2024;
- Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021-2025;
- Pyetësor dërguar drejt AKD-së dhe Intervista të drejtpërdrejta me punonjësit;

Objektivi i auditimit të masave rregullative për teknologjinë e informacionit në Agjencinë Kombëtare të Diasporës është të vlerësojë nëse janë vendosur dhe zbatohen politika, procedura dhe kontrole të përshtatshme për menaxhimin e teknologjisë së informacionit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Auditimi synon të verifikojë nëse masat rregullative sigurojnë mbrojtjen e informacionit, garantimin e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërinë e të dhënave, si dhe parandalimin dhe menaxhimin efektiv të rreziqeve të mundshme të IT-së që lidhen me veprimtarinë e Agjencisë. Përmes këtij auditimi synohet gjithashtu të vlerësohet nëse përdorimi i teknologjisë së informacionit mbështet në mënyrë efektive dhe të sigurt realizimin e funksioneve dhe objektivave institucionale të Agjencisë.

Agjencia Kombëtare e Diasporës është institucioni publik qendror që koordinon dhe zbaton politikat shtetërore në mbështetje të shqiptarëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Agjencia u krijua fillimisht në varësi të Ministrit të Shtetit për Diasporën, si një strukturë ekzekutive që synonte të forconte lidhjet me diasporën shqiptare dhe të zbatonte politikat për mbështetjen e saj.

Pas shfuqizimit të Ministrit të Shtetit për Diasporën në vitin 2021, në kuadër të ristrukturimeve të administratës qendrore, Agjencia Kombëtare e Diasporës kaloi në varësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme - MEPJ. Kjo lëvizje synonte forcimin e integritetit institucional të çështjeve të diasporës brenda politikës së jashtme të Shqipërisë, duke përmirësuar koordinimin ndër-institucional dhe duke e pozicionuar Agjencinë në një rol strategjik për ndërveprimin diplomatik dhe shërbimet konsullore.


Agjencia Kombëtare e Diasporës, ka për mision zhvillimin dhe thellimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, nëpërmjet:

- përmirësimit të pozitës së anëtarëve të diasporës, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre në vendet ku ata jetojnë;
- ofrimit të ndihmës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare;
- nxitjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;
- bashkëpunimit për prosperitetin e të gjithë kombit, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror.

Agjencia Kombëtare e Diasporës e zhvillon aktivitetin e saj në zbatim të ligjit nr. 16/2018 *“Për diasporën”*, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 120, datë 06.03.2024 *“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”*, si person juridik publik buxhetor në varësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Aktualisht, për realizimin e funksioneve të saj institucionale, Agjencia Kombëtare e Diasporës ushtron veprimtarinë në përputhje me strukturën organizative të miratuar me Urdhrin nr. 111, datë 10.09.2020, të Kryeministrit *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”*. Në bazë të kësaj strukture, Agjencia ka të miratuara 16 pozicione pune, ndërsa numri aktual i personelit është 11 punonjës.

Fig. 1: Struktura Organizative



Burimi: Agjencia Kombëtare e Diasporës

Politikat dhe rregulloret e TI-së

Në kuadër të kësaj nënpike, grupi i auditimit e orientoi punën e tij drejt shqyrtimit dhe vlerësimit të kuadrit rregullativë dhe operacional që institucionit i shërben për menaxhimin e teknologjisë së informacionit.

Me anë të VKM-së nr. 585, datë 22.07.2020, është miratuar Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021-2025, e cila përcakton parimet e politikës shtetërore të Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e komuniteteve shqiptare të cilët jetojnë në vendet pritëse në mënyrë të ligjshme duke nxitur zhvillimin e politikave shtetërore për përfshirjen dhe kontributin e tyre në zhvillimin socio-ekonomik dhe politik të vendit të origjinës. Pjesë e saj është dhe Plani i Veprimit 2021 - 2025, që përfshin objektivat dhe masat kryesore që duhen zbatuar gjatë periudhës 2021 - 2025. Sipas VKM-së nr. 120, datë 06.03.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, kreu III. Organizimi dhe Funksionimi i Agjencisë, pika 2c “Me qëllim përmbushjen e misionit e të përgjegjësive funksionale të saj, Agjencia ndjek zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës”. Megjithatë, Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021–2025 nuk përmban politika të posaçme ose plane konkrete veprimi të dedikuara për zhvillimin ose përdorimin e teknologjisë së informacionit nga Agjencia Kombëtare e Diasporës (AKD). Ndërsa dokumenti përmend digjitalizimin si aspekt mbështetës në strukturën organizative, nuk jepen masa, objektiva, apo projekte të detajuara që lidhen me zhvillimet teknologjike në funksion të misionit të Agjencisë.

Institucioni e zhvillon veprimtarinë e tij administrative dhe funksionale në bazë të Rregullores së Brendshme në fuqi, e miratuar me Vendimin nr. 1, datë 02.10.2018, “Për miratimin e Rregullores për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave të brendshme të stafit administrativ dhe mbështetës të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”. Edhe pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 21.02.2024, që përcakton krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës si institucion buxhetor në varësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, nuk është hartuar dhe miratuar një rregullore e re e brendshme që të reflektojë ndryshimet institucionale dhe të mbështesë aktivitetin e institucionit në përputhje me strukturën e re organizative, e cila gjithashtu mungon në këtë fazë. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 06.03.2024, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, në kreun III “Organizimi dhe Funksionimi i Agjencisë”, pika 7 parashikohet se: “Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë miratohet nga ministri, me propozim të titullarit të saj”. Deri më tani,

institucioni nuk ka dalë me propozime për rregulloren e brendshme, pasi ende nuk është miratuar struktura e re organizative.

Aktualisht, Agjencia funksionon ende bazuar në strukturën e miratuar me Urdhrin nr. 111, datë 10.09.2020, të Kryeministrit, *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”*. Brenda kësaj strukture përfshihet edhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Në zbatim të VKM-së nr. 120/2024, kreu III, pika 5, ku përcaktohet se shërbimet e brendshme mbështetëse dhe funksionet e menaxhimit financiar do të realizohen nga strukturat përgjegjëse përkatëse pranë ministrisë, kjo drejtori do të kalojë në varësinë e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Këto ndryshime pritet të reflektohen në strukturën e re, e cila do të miratohet në vijim.

Gjithashtu, në zbatim të Ligjit nr. 10325, datë 23.09.2010 *“Për bazat e të dhënave shtetërore”*, neni 5 ku shprehet se: *“Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij”* dhe VKM-së nr. 504, datë 24.06.2020 *“Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”*, pika 4 ku citohet se: *“Baza e të dhënave shtetërore e studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ka si institucioni administrues Agjencinë Kombëtare të Diasporës”*, me urdhrin nr.17, datë 29.04.2025 është miratuar rregullorja *“Për organizimin, funksionimin dhe sigurinë e regjistrimit elektronik për bazën e të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”*.

Roli dhe përgjegjësitë për TI-në

Si një institucion që aktualisht ndodhet në varësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), Agjencia mbështetet për nevojat e saj në fushën e IT-së nga strukturat përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), të cilat janë të atashuara pranë MEPJ-së dhe ofrojnë asistencë teknike dhe mbështetje të vazhdueshme, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 22.11.2017. Si rrjedhim, Agjencia nuk ka një njësi të mirëfilltë për teknologjinë e informacionit, pjesë të strukturës së saj organizative.

Menaxhimi i riskut

Nga shqyrtimi i veprimtarisë së institucionit dhe analizës së nevojave teknologjike, rezulton se Agjencia Kombëtare e Diasporës nuk administron sisteme komplekse të informacionit dhe nuk gjeneron apo përpunon vetë të dhëna sensitive apo kritike. Institucioni përdor kryesisht mjete bazike të teknologjisë së informacionit për nevoja të përditshme administrative, siç janë: posta elektronike, pajisjet kompjuterike për përmbushjen e detyrave funksionale dhe akses në internet. Mbështetja teknike dhe menaxhimi i infrastrukturës së TIK sigurohet nga strukturat përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), të cilat ofrojnë asistencë për zgjidhjen e problemeve të përditshme teknike.

Duke marrë parasysh natyrën dhe volumin e kufizuar të përdorimit të teknologjisë së informacionit në institucion, risku operacional në këtë fushë vlerësohet i ulët. Aktivitetet e institucionit nuk përfshijnë përpunim të të dhënave sensitive ose administrim të sistemeve komplekse, ndërsa funksionimi i përditshëm i pajisjeve dhe rrjetit mbështetet nga strukturat përkatëse të AKSHI-t pranë MEPJ. Rreziqet kryesore lidhen me ndonjë ndërprerje të

përkohshme të funksioneve bazike të punës (internet, pajisje kompjuterike) dhe përdorimin e pasigurt të postës elektronike.

Nga auditimi u konstatua se, në lidhje me teknologjinë e informacionit, përfshirë infrastrukturën, politikat e backup-it, si dhe krijimin dhe administrimin e përdoruesve, Agjencia Kombëtare e Diasporës nuk disponon akte të veçanta rregullatore të brendshme. Si pjesë përbërëse e rrjetit qeveritar e-Gov, menaxhimi i këtyre aspekteve realizohet në nivel qendror nga strukturat përgjegjëse për teknologjinë e informacionit.

Përputhshmëria me Ligjet dhe Rregulloret

Struktura organizative që institucioni ka aktualisht në dispozicion është ajo e miratuar në vitin 2020, në kohën kur Agjencia Kombëtare e Diasporës ishte në varësi të Ministrit të Shtetit për Diasporën, e përcaktuar me Urdhrin nr. 111, datë 10.09.2020, të Kryeministrit. Me anë të ligjit nr. 7/2024, është bërë shfuqizimi i ligjit nr. 115/2017 “Për krijimin e agjencisë kombëtare të diasporës” të ndryshuar. Agjencia Kombëtare e Diasporës ndodhet aktualisht në proces ristrukturimi, çka shpjegohet edhe nga dispozitat kalimtare të përcaktuara në nenin 2, pika 1, ku thuhet se: “Funksionet, kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara për Agjencinë Kombëtare të Diasporës do të vijojnë të kryhen nga kjo agjenci deri në krijimin/organizimin e institucionit/strukturës përkatëse përgjegjëse për to”.

Nga auditimi u konstatua se pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 06.03.2024, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, nuk është miratuar ende një strukturë e re organizative që të reflektojë ndryshimet institucionale dhe varësinë e re të institucionit. Në vijim të këtij procesi, mbetet për t’u miratuar edhe rregullorja e brendshme e institucionit, e cila do të përcaktojë në mënyrë të qartë organizimin, funksionet dhe përgjegjësitë e brendshme të çdo njësie strukturore.

Për sa më sipër, rezulton se institucioni ndodhet në një fazë tranzicioni institucional dhe organizativ, si rrjedhojë e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore të miratuara së fundmi. Struktura dhe veprimtaria e Agjencisë vazhdojnë të zhvillohen mbi bazën e akteve ekzistuese, të cilat nuk reflektojnë ende ndryshimet e fundit në varësinë institucionale dhe organizimin e brendshëm. Në aspektin e teknologjisë së informacionit, AKD nuk ka struktura apo politika të dedikuara, duke qenë se këto mbulohen nga rrjeti qeveritar dhe mbështetja e AKSHI-t, çka bën që përdorimi i IT-së të mbetet në funksione bazike administrative. Miratimi i strukturës së re organizative dhe rregullores së brendshme mbetet një hap i domosdoshëm për të qartësuar funksionet dhe përgjegjësitë, duke mundësuar një funksionim të plotë dhe të përditësuar të institucionit në përputhje me misionin e tij.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur disa komente mbi rekomandimet e përcjella me Projekt raportin me shkresën nr.585/4 Prot, datë 07.11.2025.

Komenti i subjektit për rekomandimin 2.1: Agjencia nuk ka një njësi të mirëfilltë për teknologjinë e informacionit, pjesë të strukturës së saj organizative dhe për nevojat e saj në fushën e IT-së mbështetet nga strukturat përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), të atashuara pranë MEPJ. Njohja me aktet rregullatore të brendshme miratuar nga Ministria përgjegjëse për teknologjinë e informacionit dhe bërja e tyre të zbatueshme, do të ndikohet nga mungesa e kapacitetit teknik/profesional të institucionit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se Agjencia është një institucion me strukturë të vogël dhe në pritje të miratimit të ndryshimeve ligjore. Për këtë grupi i auditimit është i mendimit që nevojat tuaj në fushën e IT-së mundet dhe duhet të mbështeten nga strukturat përkatëse të

Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit pranë MEPJ. Ju nuk mund të hartoni akte të veçanta për teknologjinë e informacionit, por të kërkonti të njiheni me akte administrative të IT nga AKSHI apo MEPJ, për t'i bërë ato të zbatueshme dhe të njohura nga punonjësit tuaj.

Komenti i subjektit për rekomandimin 3.1: Në kuadër të rekomandimit të grupit të auditimit mbi marrjen e masave të nevojshme për miratimin e strukturës së re organizative të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.120, datë 06.03.2024, theksojmë se aktualisht është në proces shqyrtimi dhe miratimi projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe po rishikohet ligji nr.16/2018 “Për diasporën”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa kohë ndryshimet ligjore janë në proces shqyrtimi, afatin për zbatimin e këtij rekomandimi e kemi ndryshuar nga “Menjëherë” në “Në vijimësi”.

2.2 Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input/Output

Në zbatim të pikës 2 “*Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input/Output*”, u shqyrtuan:

- Ligjin nr. 16/2018 “Për Diasporën”;
- Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- VKM nr. 945, datë 2.11.2012, “Për Miratimin E Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të Dhënave Shtetërore”;
- VKM nr. 504, datë 24.6.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”;
- VKM nr. 160, datë 19.2.2020 “Për Mbështetjen Financiare të Studentëve të Shkëlqyer dhe të Nëpunësve Civilë (Fondi i Ekselencës)”;
- VKM nr. 686, datë 02.09.2020 "Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë Shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020-2021.
- VKM nr. 447, datë 22.7.2021 "Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë Shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022;
- Kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes me Operatorin, e nënshkruar nga AKSHI;
- Manuallet e përdoruesit në sistem;
- Korrespondenca zyrtare, si shkresore ashtu edhe elektronike, etj.

Agjencia Kombëtare e Diasporës e bazon aktivitetin e saj në Ligjin nr. 16/2018 “*Për Diasporën*” dhe VKM nr. 120, datë 06.03.2024, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës*”.

Në përputhje me VKM nr. 120, datë 06.03.2024, detyrat funksionale të Agjencisë Kombëtare të Diasporës përfshijnë:

- përmirësimin e pozitës së diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të saj, aty ku gjendet;
- ofrimin e ndihmës për ruajtjen e gjuhës e të trashëgimisë kulturore kombëtare;
- nxitjen e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;
- bashkëpunimin për prosperitetin, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror të të gjithë kombit.

Bazuar në pikën 2 të VKM-së nr. 120, datë 06.03.2024, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës*”, për përmbushjen e misionit e të përgjegjësive funksionale të saj, Agjencia:

- a) merr masa për krijimin e bazës unike të të dhënave të diasporës, në bazë të vullnetit të lirë të personit. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;
- b) zbaton politika dhe projekte që lidhen me diasporën;
- c) ndjek zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës;
- ç) mban lidhjet ndërmjet diasporës, përfaqësuesve të saj dhe vendit të origjinës;
- d) bashkëpunon e koordinon aktivitetet me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e pozitës së diasporës në botë;
- dh) ndihmon për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, të vlerave kombëtare dhe kulturore të diasporës;
- e) informon diasporën për zhvillimet në vendin e origjinës, me qëllim përfshirjen e tyre në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë;
- ë) bashkëpunon me organizma vendas e ndërkombëtarë me fusha të ngjashme veprimtarie, me qëllim përthithjen e praktikave më të mira dhe krijimin e urave të bashkëpunimit.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në zbatim të pikës 2/a të VKM nr. 120, datë 06.03.2024, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, ka për detyrë marrjen e masave për krijimin e një baze unike të të dhënave të diasporës, bazuar në vullnetin e lirë të individëve. Aktualisht, të dhënat mbledhen dhe ruhen në format Excel, të siguruar kryesisht nga Ambasadat, shoqatat e diasporës dhe aktivitete të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit.

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi por edhe më parë, nuk është mundësuar vetë deklarimi elektronik nga qytetarët nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, si një mjet i drejtpërdrejtë komunikimi për ndërtimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave bazuar në parimin e vullnetit të lirë të individit.

Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, kërkon që çdo bazë të dhënash:

- Të krijohet me ligj ose VKM (neni 4);
- Të regjistrohet në ARK dhe të jetë ndërvepruese vetëm për të dhënat parësore (neni 8);
- Të përmbushë kriteret e auditimit, sigurisë, dhe strukturës teknike sipas VKM nr. 945, datë 2.11.2012, “Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të Dhënave Shtetërore”.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës/pika 1, të nenit 4 të Ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të shkronjës “a”, të nenit 5 të Ligjit nr. 16/2018 “Për Diasporën”, me VKM nr. 504, datë 24.6.2020 është krijuar baza e të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë. Baza e të dhënave shtetërore, sipas këtij vendimi, bazuar në nenin 2, përmban të dhëna personale për:

- a. shtetasit shqiptarë, të cilët kryejnë studimet universitare jashtë vendit;
- b. shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë.
- c. shtetasit shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit të cilat i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë.

Nga auditimi u konstatua se baza e të dhënave shtetërore e studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë, e krijuar me VKM nr. 504, datë 24.06.2020, nuk është një grumbullim i organizuar i informacionit, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhen nëpërmjet

një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të institucionit administrues, sikurse përcaktohet në nenin 4 , pika 2 e VKM nr. 945, datë 2.11.2012 “Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të Dhënave Shtetërore”.

Bazuar në përcaktimet e nenit 4 , pika 2 e VKM nr. 945, datë 2.11.2012 “Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të Dhënave Shtetërore”, nga auditimi u konstatua se përpunimi dhe përditësimi i informacionit të grumbulluar në bazën e të dhënave shtetërore nuk kryhet nëpërmjet sistemit kompjuterik nga institucionet të përcaktuara si institucionet dhënëse të informacionit, sipas nenit 6 të VKM nr. 504, datë 24.06.2020.

Nga auditimi u konstatua se sistemi informatik nuk është ndërtuar bazuar mbi një dokumentacion të plotë rregullativë, por bazuar në VKM nr. 504, datë 24.06.2020, në të cilën nuk specifikohet asnjë dokumentacion teknik, arkitekturë, nivel sigurie, apo masa sigurie, sikurse përcaktohet në nenet 6, 11, 17-21 të VKM nr. 945, datë 2.11.2012 “Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të Dhënave Shtetërore”.

Në pikën 4 të VKM nr. 504, datë 24.06.2020, përcaktohet se baza e të dhënave shtetërore e studentëve, që studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, që përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ka si institucion administrues Agjencinë Kombëtare të Diasporës. Në nenin 6 të VKM nr. 504, datë 24.06.2020, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe Ministria përgjegjëse për punët e jashtme janë përcaktuar si dhënëse të informacionit.

MASR në zbatim të VKM nr. 160, datë 19.2.2020 “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”, administron procedurën e regjistrimit, verifikimit dhe menaxhimit të bursave të studimit përfituar nga shtetasit shqiptarë, të cilët kryejnë studimet universitare jashtë vendit, si dhe shtetasit shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit që i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë. Kjo verifikohet dhe nga të dhënat e përcjella në rrugë shkresore apo email nga MASR në përgjigje të kërkesave që i ka përcjellë Agjencisë Kombëtare të Diasporës për popullimin e të dhënave të këtij sistemi.

Të dhënat që përmban kjo bazë të dhënash, ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë:

a) Të dhëna parësore konsiderohen:

- periudha e studimeve;
- shteti pritës;
- institucionin e arsimit të lartë pranë të cilit studion;
- fusha e studimeve;
- burimi i financimit të bursës;
- adresa e postës elektronike (e-mail);
- të dhënat e shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të këtij vendimi: - Emri; - Mbiemri; - Atësia; - Adresa; - Gjinia; - Vendlindja; - Datëlindja.

Të dhënat dytësore që do të shkëmbehen me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (DPGjC), janë: NID-i i shtetasit, Emri, Mbiemri, Atësia, Adresa, Gjinia, Vendlindja, Datëlindja.

Nga auditimi u konstatua se:

- Të dhënat janë përshkruar në mënyrë të përgjithshme dhe tek të dhënat dytësore përfshihen të njëjtat fusha si ato parësore, ku Ligji 10325, datë 23.9.2010, neni 7 përcakton se ndalohet që të njëjtat të dhëna të jenë njëkohësisht parësore dhe dytësore.
- Në VKM nr. 504, datë 24.06.2020, parashikohet ndërveprim, por ky ndërveprim nuk përmendet se lejohet vetëm me të dhënat parësore, ku në nenin 8 të Ligjit nr. 10325, ndalohet ndërveprimi me të dhëna dytësore.

- Ligji nr.10325, neni 10 dhe VKM nr. 945, datë 2.11.2012, “Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të Dhënave Shtetërore”, gjithë kapitulli IV, përcaktojnë qartësisht rolin mbikëqyrës dhe koordinues të ARK, që nuk përmenden në VKM nr. 504, datë 24.06.2020.

Për sa më sipër, VKM nr. 504/2020 nuk përputhet me kuadrin ligjor ekzistues të bazave të dhënave shtetërore dhe baza e të dhënave e ndërtuar bazuar mbi këtë Vendim nuk mund të funksionojë ligjërisht dhe teknikisht dhe nuk mund të përdoret për ndërveprim me sisteme të tjera shtetërore.

Në nenin 2, pika 2 në ligjin nr. 16/2018 “Për Diasporën”, përcakton se kategoritë që përfshihen në këtë grup janë:

a) komunitetet e hershme shqiptare në botë;

b) çdo person, i cili është lindur në Shqipëri dhe jeton jashtë kufijve të saj;

c) çdo person që gëzon origjinë shqiptare, i cili ka lindur jashtë kufijve të Shqipërisë, mban lidhje gjuhësore, kulturore e të traditës në vazhdimësi dhe që ka dëshirë të ruajë lidhjet me Shqipërinë. Në nenin 6 të VKM nr. 504, datë 24.06.2020, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe Ministria përgjegjëse për punët e jashtme janë përcaktuar si dhënës të informacionit.

Të dhënat që janë përcjellë tek Agjencia Kombëtare e Diasporës, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në rrugë shkresore dhe elektronike në formatin Excel, për studentët ekselentë, janë të dhënat që krijohen në zbatim të VKM nr. 160, datë 19.2.2020 “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”. MAS administron procedurën e pranimit të aplikimeve, regjistrimit, verifikimit, menaxhimit të bursave të studimit, si dhe detyrimet për financimin e studimeve universitare kryer jashtë vendit, si dhe shtetasit shqiptarë, të cilët kanë përfutur bursat e studimit që i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë.

Në pikën 7 të VKM nr. 504, datë 24.06.2020 citohet se “vlerësimi i rezultateve të studenteve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, realizohet nga një komision i veçantë me 9 (nëntë) anëtarë, nga institucionet përgjegjëse, i cili ngrihet me urdhër të Kryeministrit. Ai drejtohet nga ministri përgjegjës për diasporën. Komisioni realizon një raport vjetor për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nën komisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë. Dhënia e bursave shtetasve të huaj me origjinë shqiptare bëhet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe rregullohet me akte të tjera”.

Në zbatim të pikës më lart janë miratuar:

- VKM nr. 686, datë 02.09.2020 "Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë Shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020-2021.

- VKM nr. 447, Datë 22.7.2021 "Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë Shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022.

Megjithëse janë miratuar kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë Shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për dy vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022, nga të dhënat dhe informacionet e vëna në dispozicion nuk rezulton të jenë planifikuar dhe kryer pagesa për bursa shtetasve të huaj me origjinë shqiptare nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi që i takon vitit akademik 2022-2023 dhe 2023-2024, me kalimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës nga një institucion autonom në institucion varësie në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ky proces nuk ka vazhduar.

Procedura për krijimin e bazës së të dhënave të studentëve ka nisur në muajin korrik 2020 me shkresën nr. 236, datë 10.07.2020 nëpërmjet së cilës Agjencia Kombëtare e Diasporës i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për përcaktimin e termave të referencës. Me komunikimet e vazhdueshme për ngritjen e grupeve të punës ndërmjet AKSHI-t, MASR, MEPJ dhe AKD-së, me shkresën nr. 258/3, datë 19.11.2020, AKSHI ka njoftuar agjencinë se ka përfunduar hartimi i termave të referencës dhe përlllogaritja e fondit limit në vlerën 17,688,000 lekë pa TVSh, nga të cilat 12,494,400 lekë janë vlerë implementimi dhe 5,193,600 lekë janë mirëmbajtje për 4 vjet.

Në specifikimet teknike nuk janë kërkuar pajisje, pasi instalimi i këtij sistemi do të bëhet në server virtual të vendosur në dispozicion nga AKSHI.

Sipas specifikimeve teknike, objektivi i përgjithshëm i projektit është automatizimi i procedurës së përfitimit të bursave të studimit nga Republika e Shqipërisë i cili do të përmirësojë procesin e regjistrimit, verifikimit dhe menaxhimit të të dhënave të nevojshme të studentëve që studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare që përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë.

Në specifikimet teknike janë përcaktuar të dhënat parësore dhe dytësore për kategoritë/programet e financimit si më poshtë:

- Përfitues nga fondi i Ekselencës;
- Përfitues nga bursat e ofruara nga qeveri të vendeve të ndryshme, në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe;
- Përfitues nga programe të ndryshme ndërkombëtare;
- Të arsimuar jashtë vendit me vetëfinancim.

Ndërsa, lista e programeve të financimit krijuar në sistem rezulton të jetë për:

- Përfitues nga Fondi i ekselencës;
- Bursa në kuadër të marrëveshjes që ka Republika e Shqipërisë me Hungarinë;
- Bursa në kuadër të marrëveshjes që ka Republika e Shqipërisë me Turqinë;
- Programi Fullbright;
- Fondi i ekselencës 2020-2021.

Nga auditimi i listës së programeve të financimit u konstatua se që prej termave teknike të hartuar në bashkëpunim me AKSHI-n, nuk është përcaktuar kategorizimi i të dhënave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë, kërkuar në pikën 2.b të VKM-së nr. 504, datë 24.06.2020.

Nga verifikimet në sistem u konstatua se kategoria për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe kategoria Të arsimuar jashtë vendit me vetëfinancim, nuk janë krijuar në sistem.

Mbledhja e të dhënave për shtetasit e arsimuar jashtë vendit me vetëfinancim, një kategori e cila mund të sigurohet përmes vetë deklarimit, nuk ka qenë e mundur pasi nuk ishte ofruar një mundësi funksionale online në faqen web të Agjencisë për ofrimin e mundësisë së deklarimit.

Sipas pikës 6 në VKM nr. 504, datë 24.6.2020, dhënës të informacionit për bazën e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, janë ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punët e jashtme.

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi por edhe më parë, nuk ka patur asnjë kërkesë për aksesimin e sistemit nga asnjë institucion i jashtëm, megjithëse përcaktohet në se

baza e të dhënave shtetërore mund të aksesohet nga të gjitha institucionet e interesuara nëpërmjet kërkesës së drejtuar Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Efektet financiare që kanë rrjedhur nga zbatimi i vendimit nr. 504, janë përballuar nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Mirëmbajtja 4 vjeçare e këtij sistemi ka përfunduar në maj 2025, ndërsa pagesat e kryera për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit për periudhën 2021 – 2025 janë si më poshtë:

Viti	Lloji i shpenzimit	Vlera e likuiduar me TVSh (në lekë)	Urdhër shpenzimi
2021	<i>Shpenzime të instalimit të sistemit</i>	14,913,600.00	nr.52, datë 29.04.2021
2021-2025	<i>Shpenzime mirëmbajtje</i>	5,054,400.00	
2021	25.04.2021-24.05.2021 (1)	129,600.00	nr.95, date 25.08.2021
	25.05.2021-24.06.2021 (2)	129,600.00	nr.96, date 24.08.2021
	25.06.2021-25.07.2021 (3)	129,600.00	nr.99, date 26.08.2021
	25.07.2021-24.08.2021 (4)	129,600.00	nr.119, date 30.09.2021
	25.08.2021-24.09.2021 (5)	129,600.00	nr.137, date 28.10.2021
	25.09.2021-24.10.2021 (6)	129,600.00	nr.167, date 17.12.2021
	25.10.2021-24.11.2021 (7)	129,600.00	nr.168, date 17.12.2021
	25.11.2021-24.12.2021 (8)	129,600.00	nr.176, date 31.12.2021
		Nëntotali	1,036,800.00
2022	25.12.2021-24.01.2022 (9)	129,600.00	likuiduar nga MEPJ
	25.01.2022-24.02.2022 (10)	129,600.00	likuiduar nga MEPJ
	25.02.2022-25.03.2022 (11)	129,600.00	nr.125, date 11.12.2024
	25.03.2022-25.04.2022 (12)	129,600.00	nr.125, date 11.12.2024
	25.04.2022-25.05.2022 (13)	129,600.00	nr.126, date 13.12.2024
	25.05.2022-25.06.2022 (14)	129,600.00	nr.125, date 11.12.2024
	25.06.2022-25.07.2022 (15)		Sistemi nuk ka funksionuar për arsye të sulmeve kibernetike
	25.07.2022-25.08.2022 (16)	129,600.00	nr.125, date 11.12.2024
	25.08.2022-25.09.2022 (17)	129,600.00	nr.125, date 11.12.2024
	25.09.2022-25.10.2022 (18)	129,600.00	nr.125, date 11.12.2024
	25.10.2022-25.11.2022 (19)	129,600.00	nr.125, date 11.12.2024
	25.11.2022-25.12.2022 (20)	129,600.00	nr.125, date 11.12.2024
		Nëntotali	1,425,600.00
2023	25.12.2022-25.01.2023 (21)	129,600.00	nr.126, date 13.12.2024
	25.01.2023-25.02.2023(22)	129,600.00	nr.126, date 13.12.2024
	25.02.2023-25.03.2023 (23)	129,600.00	nr.126, date 13.12.2024
	25.03.2023-25.04.2023 (24)	129,600.00	nr.126, date 13.12.2024
	25.04.2023-25.05.2023 (25)	129,600.00	nr.126, date 13.12.2024
	25.05.2023-25.06.2023 (26)	129,600.00	nr.126, date 13.12.2024
	25.06.2023-25.02.2024 (27-34)		Nuk është ofruar shërbim nga OE "BNT"
		Nëntotali	777,600.00
2024	26.02.2024-25.03.2024 (35)	129,600.00	nr.127, date 13.12.2024
	26.03.2024-25.04.2024 (36)	129,600.00	nr.127, date 13.12.2024
	25.04.2024-24.05.2024 (37)	129,600.00	nr.127, date 13.12.2024
	26.05.2024-25.06.2024 (38)	129,600.00	nr.127, date 13.12.2024
	26.06.2024-25.07.2024 (39)	129,600.00	nr.127, date 13.12.2024

	26.07.2024-25.08.2024 (40)	129,600.00	nr.127, date 13.12.2024
	26.08.2024-25.09.2024 (41)	129,600.00	nr.127, date 13.12.2024
	26.09.2024-25.10.2024 (42)	129,600.00	nr.127, date 13.12.2024
	26.10.2024-25.11.2024 (43)	129,600.00	nr.127, date 13.12.2024
	26.11.2024-25.12.2024 (44)	129,600.00	nr.146, date 28.12.2024
	Nëntotali	1,296,000.00	
2025	26.12.2024-25.01.2025 (45)	129,600.00	nr.54, date 05.06.2025
	26.01.2025-25.02.2025 (46)	129,600.00	nr.54, date 05.06.2025
	26.02.2025-25.03.2025 (47)	129,600.00	nr.54, date 05.06.2025
	26.03.2025-25.04.2025 (48)	129,600.00	nr.54, date 05.06.2025
	Nëntotali	518,400.00	

Burimi: Të dhëna nga Agjencia Kombëtare e Diasporës


Për periudhat që nuk është ofruar shërbim, nuk janë kryer pagesa nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Nga auditimi mbi të dhënat që gjenden në sistem, për 5 programe financimi rezultojnë të regjistruar 230 studentë, të cilët kanë përfituar 356 aplikime. Për popullimi e të dhënave të sistemit të ndërtuar për administrimin e studentëve në diasporë, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka përcjell disa kërkesa shkresore tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe tek Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Në përgjigje të këtyre kërkesave është përcjellë informacion elektronik nëpërmjet shërbimit postar si dhe postës elektronike vetëm nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve për studentët e financuar nga fondet e Ekselencës, ku informacioni i fundit i përcjellë është protokolluar në Agjencia Kombëtare e Diasporës me shkresën nr. 1322/3, datë 24.01.2025, ku gjenden të dhënat për vitin akademik 2024-2025.

Për periudhën 2014-2022 MAS ka përcjellë të dhënat që gjenden në sistem për 230 përfitues. Të dhënat parësore për këta përfitues janë: emër, mbiemër, datëlindja, gjinia, fusha e studimit, kohëzgjatja e studimeve, viti i regjistrimit, emri i universitetit dhe shteti i universitetit.

Nga auditimi u konstatua se mungesa e të dhënës unike identifikuese të studentit që është NID, në asnjë rast nuk është një e dhënë e dërguar nga MAS dhe e plotësuar në sistem, dhe në mungesë të saj nuk ka patur shkëmbim me të dhënat dytësore të DPGjC për: emrin, mbiemrin, atësinë, adresën, gjininë, vendlindjen, datëlindjen sikurse përcaktohet në VKM nr. 504 datë 24.6.2020.

Fig.1 – Programet, Studentët e regjistruar si dhe aplikimet



Burimi: Printscreen i sistemit

Të dhënat që ka përcjellë Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk janë të plota dhe në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 504, datë 24.06.2020. Në mungesë të NID të studentëve, regjistrimi i rekordeve në sistem ka qenë i pamundur nga administratori i sistemit që është punonjëse e Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Këto të dhëna, sa herë ka qenë e nevojshme, i janë përcjellë Operatori Ekonomik për të realizuar importimin e tyre në sistem, pasi këto regjistrime nuk mund të realizoheshin nga ndërfaqja, duke ekspozuar këto të dhëna tek të tretët, megjithëse Agjencia ka detyrimin për mbrojtjen e tyre bazuar në aktet ligjore në fuqi.

Në lidhje me sa më sipër, Agjencia Kombëtare e Diasporës që prej ndërtimit të këtij sistemi, ku përfshihet dhe periudha objekt auditimi, ka administruar një bazë të dhënash të populluar me të dhënat e aktivitetit të MASR sipas VKM nr. 160, datë 19.2.2020, duke krijuar mbivendosje funksionesh dhe paqartësi, për përgjegjësinë mbi administrimin e të dhënave personale të studentëve që kanë përfituar bursa jashtë vendit.

Agjencia nuk kryen analiza, verifikime apo raportime mbi këto të dhëna, pasi ato nuk janë tregues i aktivitetit të saj.

Ka filluar një komunikim për vijimin e procedurës për mirëmbajtjen e sistemit, ku Agjencia Kombëtare e Diasporës ka përcjellë tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit shkresën nr. 69 Prot. datë 04.04.2025 për vijimin e procedurave dhe komunikimi ka vijuar me përgjigjen me nr. 69/1 Prot., datë 14.04.2025, si dhe shkresën nr. 69/3 Prot. datë 30.05.2025.

Përfundimi i kontratës së shërbimit është nënkuptuar dërgimi i raportit të fundit të mirëmbajtjes i cili është nënshkruar nga ndjekësit e kontratës. Në këtë raport përfundimtar nuk ka asnjë informacion apo njoftim për kohën e përfundimit të mirëmbajtjes pas së cilës operatori ekonomik nuk mundet të aksesojë sistemin në çdo problem të tij.

Në Agjencinë Kombëtare të Diasporës dhe tek ndjekësit e kontratës nuk ka asnjë gjurmë për dorëzimin e llogarive të operatorit ekonomik që janë krijuar dhe përdorur gjatë mirëmbajtjes, dita e fundit në të cilin është kryer një backup i sistemit që për çdo mos funksionalitet AKD të mundet të kthehet për këto të dhëna, si dhe detaje të tjera teknike që nevojitet ti transferohen Autoritetit Kontraktor që është AKSHI dhe AKD si institucion përfitues.


Lidhur me kërkesën për këtë informacion nga grupi i auditimit, Agjencia Kombëtare e Diasporës kërkoi informacion tek operatori ekonomik me shkresën nr. 131 Prot., datë 10.07.2025 me lëndë: Kërkesë për informacion mbi raportin përmbyllës të kontratës nr. 1225 Prot., datë 25.02.2021 *“Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të studentëve që studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare që përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”*. Operatori ekonomik është përgjigjur se raportet përfundimtare dhe periodike që ka patur detyrim janë dorëzuar me implementimin e sistemit. Gjithashtu, po në vijim të këtij diskutimi Agjencia Kombëtare e Diasporës ka përcjellë tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit shkresën nr. 132 Prot., datë 10.07.2025 për informacion nëse një raport përfundimtar është dorëzuar tek AK nga OE.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka kërkuar tek Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 130 Prot., datë 10.07.2025 informacion nëse MAS disponon:

- Një databazë apo të dhëna të strukturuar për shtetasit shqiptarë, të cilët ndjekin studimet universitare në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit;
- Një databazë ose të dhëna për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë;
- Informacion mbi shtetasit shqiptarë që kanë përfituar bursa studimi të ofruara për Shqipërinë nga shtetet e huaja, organizata ndërkombëtare ose organizata jofitimprurëse, në bazë të marrëveshjeve ku Republika e Shqipërisë është palë.

Në përgjigjen e saj MAS ka dërguar përgjigje e protokolluar në MEPJ me nr. 10682 Prot., datë 28.07.2025, janë përcjellë disa të dhëna por nuk është dhënë asnjë sqarim nëse ka një bazë të dhënash apo të dhëna të strukturuar për shtetasit shqiptarë, të cilët ndjekin studimet universitare në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë.

Gjatë testimeve të funksionaliteteve që janë ndërtuar në sistem, u konstatuan disa “errors”, ku një prej tyre ishte testimi i ndërveprimit për krijimin e një studenti të ri në sistem, ku si NID u përdor numri i ndjekësit të kontratës përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Ky testim nuk mundi të përfundonte me sukses pasi sistemi gjeneron një gabim, duke e bërë të pamundur përfundimin e testimit dhe marrjen e rezultateve të tij.



```
Symfony\Component\HttpKernel\Exception\MethodNotAllowedHttpException PHP 8.2.22 11.21.0
The POST method is not supported for route studentet/nid. Supported methods: GET, HEAD, PUT, PATCH, DELETE.

Expand vendor frames
27 vendor frames
C:\inetpub\wwwroot\AKSHI_StudentsWeb\public\index.php:54
32 | This bootstraps the framework and gets it ready for use, then it
33 | will load up this application so that we can run it and send
34 | the responses back to the browser and delight our users.
35 |
36 */
37
38 $app = require_once __DIR__.'../bootstrap/app.php';
39
40 /*
41 |-----
42 | Run The Application
43 |-----
44 |
45 | Once we have the application, we can handle the incoming request
46 | through the kernel, and send the associated response back to
47 | the client's browser allowing them to enjoy the creative
48 | and wonderful application we have prepared for them.
49 |
50 */
51
52 $kernel = $app->make(Illuminate\Contracts\HttpKernel::class);
```

Nga auditimi mbi funksionalitetet e sistemit u konstatua se:

- Me përfshirje në infrastrukturën e Ministrisë së Jashtme aksesimi në sistem është bërë i mundur nëpërmjet Microsoft Entra ID, i cili siguron hyrjen në sistem për punonjësit duke përdorur një identitet të unifikuar nëpërmjet emailit të punës. Konfigurimi i aksesimit të sistemit me Entra ID ka bërë të mundur aksesimin e tij dhe nga punonjësit që nuk kanë përdorues në sistem, pasi hyrja me Entra ID nuk është e kufizuar.
- Janë aktiv dy përdorues me atributet e administratorit të sistemit, ku njëri prej tyre është i OE që ka ofruar mirëmbajtjen.

Ky sistem elektronik mirëmbahet nga operatori ekonomik BNT ELECTRONICS

Lista e përdoruesve të sistemit Kreu / Lista e përdoruesve të sistemit

Show 10 entries Search:

Emri i përdoruesit	Emaili i përdoruesit	Roli i përdoruesit
Altin Selimi	altin.selimi@akd.gov.al	Modifikues
Dife Salliu	dife.salliu@akd.gov.al	Krijues
Sidorela Paraspuari	sidorela.paraspuari@akd.gov.al	Administrator
Xhuljana Beca	xh.beca@bntelectronics.com	Administrator
Emri i përdoruesit	Emaili i përdoruesit	Roli i përdoruesit

Showing 1 to 4 of 4 entries Previous 1 Next

- Nga verifikimet e kryera rezultojnë se në modulën e menaxhimit të studentëve, për të gjithë listën e studentëve mungojnë të dhënat dytësore si: NID i studentit, atësia, adresa, vendlindja, datëlindja, adresa e postës elektronike.
- Të dhënat demografike të studentëve ku nëpërmjet grafikut (*pie chart*) tregohen raporti i studentëve të regjistruar në sistem sipas moshës, gjinisë dhe shtetit, konstatohet se grafiku nuk tregon asnjë të dhënë për studentët e gjinisë 'femër', por vetëm për gjininë 'meshkuj'.

Faqja web e Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Bazuar në vendimin nr. 120, datë 06.03.2024 të Këshillit të Ministrave, "Për Krijimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës", me shkresën nr. 208. Prot datë 06.11.2024 ka iniciuar procesin e ridizenjimit të faqes web të AKD (<https://akd.gov.al/>) dhe ka vlerësuar të rëndësishëm që imazhi dhe funksionaliteti i Agjencisë të përshatet me standardet e reja të planit strategjik. Përmirësimi mbi aksesimin e faqes është i domosdoshëm për të përbushur pritshmëritë e grupeve të interesit, për të rritur transparencën, dhe të forcojë lidhjen e saj me diasporën shqiptare.

Agjencia mund të sigurojë të dhëna për Diasporën vetëm nëpërmjet vetë deklaratimit, por nga auditimi mbi faqen web u konstatua se nuk është ofruar një mundësi vetë deklarimi nëpërmjet faqes web, për vetë deklarimin e studentëve me vetëfinancim dhe për mbledhjen e të dhënave të diasporës, në kuadër të përbushjes së pikës 2.a të VKM nr. 120, datë 06.03.2024, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës". Punonjës të AKD-së, shprehen se pasiguria në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale perceptohet si një faktor pengues në mungesën e angazhimit për deklarim të lirë dhe vullnetar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur disa komente mbi rekomandimet e përcjella me Projekt raportin me shkresën nr.585/4 Prot, datë 07.11.2025.

Komenti i subjektit për rekomandimin 1.1: Deri në ndarjen e qartë të përgjegjësive për administrimin e sistemit nuk mund të kryhen ndërhyrje dhe përmirësime të tij. Agjencia Kombëtare e Diasporës nuk zotëron kapacitete teknike në burimet e saj njerëzore, për administrimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të bazës së të dhënave shtetërore dhe prej ndërtimit të këtij sistemi ka administruar një bazë të dhënash të populluar me të dhënat e aktivitetit të Ministrisë së Arsimit sipas VKM nr.160 datë 19.02.2020, propozojmë që administrimi i bazës së të dhënave të kalojë Ministrisë së Arsimit. Këto ndryshime do të shmangin mbivendosjen e funksioneve dhe ndarjen e qartë të përgjegjësive mbi administrimin e të dhënave personale të studentëve që kanë përfituar bursa jashtë vendit. Propozimi mbështetet edhe në vetë faktin që Ministria e Arsimit është institucion përgjegjës për arsimin dhe disponon të dhëna të plota dhe të sakta për studentët shqiptarë që studiojnë jashtë vendit. Për këtë Agjencia ka ndërmarrë masat si më poshtë: Është draftuar Memo dhe pritjet miratim të Ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme lidhur me ndryshimet e propozuara në aktet nënligjore: Vendimin nr. 504, datë 24.6.2020 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve

të cilët **studiojnë jashtë vendit**” si dhe Vendim i Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë”. Propozimi për ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave sipërcituar synon të qartësojë përgjegjësitë e institucioneve të ngarkuara me zbatim duke revokuar përgjegjësinë e MEPJ/AKD në këtë proces. Gjithashtu, në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) për vitin 2026 janë propozuar për ndjekje shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 120, datë 6.3.2024 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, që prekin ndryshime në strukturën organizative të institucionit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet për rekomandimin 1.1, kuptojmë se keni filluar me marrjen e masave dhe rekomandimi i grupit ju sugjeron të rishikoni dhe përcaktoni përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet për një bazë të dhënash shtetërore që është populluar vetëm me të dhëna nga MAS.

Komenti i subjektit për rekomandimin 4.1 dhe 5.1: Agjencia nuk ka një njësi të mirëfilltë për teknologjinë e informacionit, pjesë të strukturës së saj organizative dhe për nevojat e saj në fushën e IT-së mbështetet nga strukturat përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit - AKSHI, të atashuara pranë MEPJ. Njohja me aktet rregullatore të brendshme miratuar nga Ministria përgjegjëse për teknologjinë e informacionit dhe bërja e tyre të zbatueshme, do të ndikohet nga mungesa e kapacitetit teknik/profesional të institucionit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se Agjencia nevojitet të zbatojë aktet administrative të miratuara nga AKSHI dhe MEPJ, kur bëhet fjalë për fushën e teknologjisë së informacionit. Rekomandimi synon që institucioni juaj të mos hartojë akte të veçanta administrative në këtë drejtim, për të ruajtur unifikimin dhe përputhshmërinë me politikat kombëtare në fushën e TI-së.

Komenti i subjektit për rekomandimin 6.1: Agjencia Kombëtare e Diasporës është në proces të ndjekjes së veprimeve të nevojshme për sigurimin e dokumentacionit teknik dhe funksional të sistemit, në përputhje me kërkesat e konstatuara nga auditimi.

Agjencia është drejtuar me shkresë zyrtare nr. 229/1 datë 05.11.2025 Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit - AKSHI, si institucion kontraktues dhe autoritet teknik përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve shtetërore të informacionit, me qëllim vijimësinë e funksionimit të sistemit të databazës dhe përditësimeve të tij. Ky hap do të mundësojë rishikimin e konfigurimeve teknike dhe garantimin e funksionalitetit të plotë të sistemit në përputhje me standardet e sigurisë së informacionit ISO 27001 dhe me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi. Bazuar në situatën e paraqitur, i jemi drejtuar me shkresën nr.134 Prot., datë 14.07.2025 Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit - AKSHI, për të kuptuar qartë statusin e përmbylljes së kontratës dhe ende nuk kemi marrë përgjigje nga ky institucion. Në rast se AKSHI konfirmon se kontrata është përmbjllur në mënyrë formale, rekomandojmë të kërkohet një përmbledhje e shkruar e gjithë periudhës së kontratës për arkivimin dhe dokumentimin e duhur institucional.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në kushtet kur angazhimi juaj është i shprehur qartë, nevojitet dhe bashkëpunimi i AKSHI-t për dokumentacionin e plotë teknik dhe funksional të sistemit, ku përfshihet dorëzimi i llogarive të operatorit dhe aksesit në sistem, backup-et e fundit të të dhënave dhe sistemit, si dhe parametrat dhe konfigurimet teknike të nevojshme për funksionimin e sistemit, në mënyrë që sistemi të kthehet nga kopjet rezerve në gjendje funksionale.

Komenti i subjektit për rekomandimin 7.1: Në lidhje me rekomandimin e lënë nga auditimi, sqarojmë se Agjencia Kombëtare e Diasporës është në proces përgatitjeje të një kërkesë zyrtare drejtuar AKSHI-t, si autoritet teknik përgjegjës për administrimin e sistemeve shtetërore të informacionit, me qëllim:

- rishikimin e aksesit në sistem dhe kufizimin e tij vetëm për përdoruesit e autorizuar institucionalë;
- përditësimin e listës së privilegjeve administrative, duke përjashtuar operatorin ekonomik pas përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes;

- verifikimin e strukturës së të dhënave për garantimin e përputhshmërisë me kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 504, datë 24.06.2020;

- koordinimin për përmirësimin e raporteve analitike dhe statistikave demografike që gjenerohen nga sistemi.

Agjencia mbetet e angazhuar që, në bashkëpunim me AKSHI-n, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për sigurimin e funksionalitetit të sistemit dhe administrimin e tij në përputhje me standardet e sigurisë së informacionit ISO 27001 dhe aktet nënligjore në fuqi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në kushtet kur angazhimi juaj është i shprehur qartë, nevojitet dhe bashkëpunimi i AKSHI-t nëpërmjet strukturës së IT në MEPJ për adresimin e parregullsive dokumentuar në rekomandimin 7.1 me qëllim zgjidhjen e tyre.

Komenti i subjektit për rekomandimin 8.1: Qeveria shqiptare po koncepton idenë e ngritjes së një platforme për vetë regjistrimin e diasporës, e ngjashme me platformën LinkedIn, në të cilën do të mund të përfshihen edhe jetëshkrimet personale të secilit profesionist. Regjistrimi në këtë platformë do të realizohet përmes vetëdeklarimit elektronik duke respektuar parimin e vullnetit të lirë të individit dhe garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mundësimi i vetëdeklarimit elektronik të diasporës edhe përmes faqes web të Agjencisë Kombëtare të Diasporës do të krijonte mbivendosje. Në momentin e ndërtimit të një platforme të tillë, Agjencia mund të pasqyrojë dhe promovojë linkun përkatës përmes faqes webfaqes së saj.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka nisur procesin e ridizenjimit të faqes web në funksion të përmirësimit të imazhit të institucionit, paraqitjes sa më të qartë dhe transparente të informacioneve dhe të forcojë lidhjen e saj me diasporën shqiptare.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky rekomandim mbetet për tu zbatuar në vijimësi bazuar në ndryshimet ligjore që po rishikohen dhe mund të sjellin impakt dhe tek Agjencia Kombëtare e Diasporës.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Diasporës administron një bazë të dhënash, në zbatim të VKM nr. 504, datë 24.6.2020 *“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”*.

Sipas përcaktimit në pikën 1 në VKM-së së sipërcituar, kjo bazë të dhënash, përmban të dhëna personale për:

- a. shtetasit shqiptarë, të cilët kryejnë studimet universitare jashtë vendit;
- b. shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë;
- c. shtetasit shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit të cilat i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë.

Gjithashtu në VKM-në e sipërcituar, në pikën 6 përcaktohet se dhënës të informacionit për bazën e të dhënave shtetërore, janë ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punët e jashtme. Të dhënat që janë përcjellë tek Agjencia Kombëtare e Diasporës, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në rrugë shkresore dhe elektronike në formatin Excel, për studentët ekselentë, janë të dhënat që krijohen në zbatim të VKM nr.160, datë 19.2.2020 *“Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”*. MAS administron procedurën e pranimit të aplikimeve, regjistrimit, verifikimit, menaxhimit të bursave të studimit, si dhe detyrimet për financimin e studimeve universitare kryer jashtë vendit, si dhe shtetasit shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit që i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë.

Nga auditimi i listës së programeve të financimit në sistemin informatik, u konstatua se që prej termave teknike të hartuar në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, nuk është përcaktuar kategorizimi i të dhënave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë, kërkuar në pikën 2.b të VKM-së nr. 504, datë 24.06.2020 *“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”*.

Nga verifikimet në sistem u konstatua se, kategoria për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe kategoria për të arsimuarit jashtë vendit me vetëfinancim, nuk janë krijuar si kategori në sistem, në kundërshtim me aktin ligjor në të cilin është ndërtuar sistemi që është VKM nr. 504, datë 24.06.2020. Gjithashtu, për periudhën objekt auditimi nuk u evidentua asnjë kërkesë nga institucione të jashtme për të aksesuar bazën e të dhënave, çka tregon për mungesë përdorimi dhe vlerësimi në praktik të këtij sistemi.

Në lidhje me sa më sipër, Agjencia Kombëtare e Diasporës që prej ndërtimit të këtij sistemi, ku përfshihet dhe periudha objekt auditimi, ka administruar një bazë të dhënash të populluar me të dhënat e aktivitetit të MASR sipas VKM nr. 160, datë 19.2.2020, duke krijuar mbivendosje funksionesh dhe paqartësi, për përgjegjësinë mbi administrimin e të dhënave personale të studentëve që kanë përfituar bursa jashtë vendit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të marrin masat e nevojshme që ky sistem të administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, e cila është përgjegjëse për

menaxhimin e mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të Republikë së Shqipërisë, me qëllim për të adresuar përgjegjësinë për të dhënat dhe përditësimin e tyre.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në lidhje me teknologjinë e informacionit, përfshirë infrastrukturën, politikat e backup-it, si dhe krijimin dhe administrimin e përdoruesve, Agjencia Kombëtare e Diasporës nuk duhet të ketë akte të veçanta rregullatore të brendshme, në kushtet që është pjesë përbërëse e rrjetit qeveritar e-Gov, menaxhimi i këtyre aspekteve realizohet në nivel qendror në zbatim të ISO/IEC 27001 “Për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit” nga strukturat përgjegjëse për teknologjinë e informacionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Diasporës të njihet me aktet rregullatore të brendshme të miratuara dhe/ose zbatuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për fushën e teknologjisë së informacionit dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për t’i bërë ato të zbatueshme dhe të njohura nga punonjësit e saj, si pjesë e veprimtarisë funksionale të institucionit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua mungesë e strukturës së re organizative dhe përmirësimi i rregullores së brendshme të institucionit referuar ndryshimeve ligjore, si elementë të domosdoshëm për funksionimin e tij. Kjo mangësi bie në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 120, datë 06.03.2024, e cila përcakton detyrimin për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, duke kërkuar përshtatjen e strukturës dhe rregullores së brendshme me ndryshimet institucionale dhe varësinë e re të institucionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të marrin masat e nevojshme për miratimin e strukturës së re organizative, duke reflektuar ndryshimet institucionale dhe varësinë e re të institucionit. Gjithashtu, AKD të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme, ku të përcaktohet qartë funksionet dhe përgjegjësitë e secilës njësi sipas strukturës.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sistemi informatik i ndërtuar bazuar në VKM nr. 504, datë 24.06.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”, nuk është ndërtuar bazuar mbi një dokumentacion të plotë rregullativë, sikurse përcaktohet në kuadrin ligjor ekzistues për administrimin e bazave shtetërore të të dhënave, konkretisht me Ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe VKM nr. 945, datë 2.11.2012, “Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të Dhënave Shtetërore”. Mangësitë kryesore të konstatuara janë:

- Përpunimi dhe përditësimi i informacionit nuk kryhet nëpërmjet një sistemi kompjuterik nga institucionet dhënëse të informacionit, në kundërshtim me nenin 4 të VKM nr. 945/2012;
- Të dhënat parësore dhe dytësore nuk janë ndarë sipas kërkesave ligjore; një pjesë e të dhënave të njëjta janë klasifikuar si parësore dhe dytësore, gjë që ndalohet nga neni 7 i Ligjit nr. 10325/2010;
- VKM nr. 504/2020 parashikon ndërveprim të bazës së të dhënave me sisteme të tjera, pa specifikuar kufizimin vetëm tek të dhënat parësore, në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit nr.10325/2010;
- Roli i Arkivit Qendror Shtetëror si organ mbikëqyrës dhe koordinues, i përcaktuar në Ligjin nr. 10325/2010 dhe VKM nr. 945/2012, nuk është parashikuar në VKM nr. 504/2020.

Për sa më sipër, baza e të dhënave e ngritur me VKM nr. 504/2020 nuk është në përputhje me kuadrin ligjor për administrimin e bazave shtetërore të të dhënave. Për pasojë, ajo nuk mund të funksionojë ligjërisht dhe teknikisht dhe nuk mund të përdoret për ndërveprim me sisteme të tjera shtetërore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe institucionet dhënëse të informacionit, të marrin masa për hartimin dhe plotësimin e dokumentacionit të plotë rregullativë dhe teknik të sistemit të ndërtuar për studentët të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë, duke përfshirë arkitekturën funksionale, infrastrukturën teknologjike, nivelet e sigurisë dhe masat e mbrojtjes së të dhënave, si kërkesa të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të administrimit të bazave të të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Gjatë testimeve të sistemit informatik ndërtuar bazuar në VKM nr.504, datë 24.06.2020, u identifikuan “errors” në testimin e krijimit të një studenti të ri ku u përdor NID i ndjekësit të kontratës të Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Ky testim dështoi pasi sistemi gjeneroi një gabim, duke penguar marrjen e rezultateve. Nuk ka gjurmë të dorëzimit të llogarive të operatorit, backup-eve të fundit të sistemit, apo detajeve teknike që duhet të transferohen tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si Autoriteti Kontraktor dhe të jetë bërë me dije Agjencia Kombëtare e Diasporës si institucion përfitues. Për sa më sipër, mungon dokumentacioni dhe gjurmimi teknik që siguron qarkullimin e informacionit dhe funksionalitetin e sistemit pas përfundimit të kontratës, bazuar në standardet ndërkombëtare të sigurisë së informacionit ISO27001.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të sigurojnë dokumentacion të plotë teknik dhe funksional të sistemit, ku përfshihet dorëzimi i llogarive të operatorit dhe aksesit në sistem, backup-et e fundit të të dhënave dhe sistemit, si dhe parametrat dhe konfigurimet teknike të nevojshme për funksionimin e sistemit, në mënyrë që sistemi të kthehet nga kopjet rezerve në gjendje funksionale.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionalitetet e sistemit informatik ndërtuar në bazuar në VKM nr. 504, datë 24.06.2020, u konstatua se:

- Me përfshirjen e Agjencisë Kombëtare të Diasporës në infrastrukturën e Ministrisë së Jashtme, aksesimi në sistem është bërë i mundur nëpërmjet Microsoft Entra ID, i cili siguron hyrjen në sistem për punonjësit duke përdorur një identitet të unifikuar nëpërmjet emailit të punës. Konfigurimi i aksesimit të sistemit me Entra ID ka bërë të mundur aksesimin e tij dhe nga punonjësit që nuk kanë përdorues në sistem, pasi hyrja me Entra ID nuk është e kufizuar, çfarë cenon principin e kontrollit të aksesit minimal dhe rrit mundësinë për hyrje të paautorizuar, manipulim ose keqpërdorim të të dhënave.
- Janë aktiv dy përdorues me atributet e administratorit të sistemit, ku njëri prej tyre është i OE që ka ofruar mirëmbajtjen, duke rritur varësinë nga palë të treta dhe rrezikun për abuzim ose ekspozim të të dhënave sensitive.
- Nga verifikimet e kryera rezulton se në modulën e menaxhimit të studentëve, për të gjithë listën e studentëve mungojnë të dhënat dytësore si: NID i studentit, atësia, adresa, vendlindja, datëlindja, adresa e postës elektronike, duke sjellë regjistrime të paplota dhe pamundësi për identifikim unik.
- Të dhënat demografike të studentëve ku nëpërmjet grafikut (*pie chart*) tregohen raporti i studentëve të regjistruar në sistem sipas moshës, gjinisë dhe shtetit, konstatohet se grafiku nuk

tregon asnjë të dhënë për studentët e gjinisë ‘femër’, por vetëm për gjininë ‘meshkuj’, çfarë tregon për mangësi në zhvillim ose konfigurim.

Për sa më sipër, problematikat tregojnë për mangësi në ndërtimin e sistemit dhe nuk janë në përputhje me manualin e përdorimit për sistemin e krijimit të bazës së të dhënave shtetërore të studentëve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrin masa për:

- Rregullimin e aksesit në sistem: konfigurimi i hyrjes përmes Microsoft Entra ID të kufizohet vetëm për përdoruesit e autorizuar të sistemit, duke vendosur kontroll të fortë mbi menaxhimin e identiteteve dhe duke shmangur hyrjen e personave që nuk kanë rol të përcaktuar.
- Menaxhimin e privilegjeve: numri i përdoruesve me atributet e administratorit të kufizohet vetëm tek punonjësit përgjegjës të institucionit administrues, duke përjashtuar operatorin ekonomik ose palë të tjera të jashtme nga posedimi i privilegjeve administrative;
- Plotësimin e të dhënave: të sigurohet që moduli i menaxhimit të studentëve të përmbajë dhe përditësojë të gjitha të dhënat parësore dhe dytësore të kërkuara (NID, atësia, adresa, vendlindja, datëlindja, emaili), duke respektuar detyrimet ligjore për integritetin e të dhënave.
- Korrektimin e raporteve analitike: të kryhet rishikimi dhe korrigjimi i algoritmeve të raportimit demografik në sistem, në mënyrë që grafikët dhe statistikatat të pasqyrojnë në mënyrë të plotë dhe të saktë të dhënat sipas gjinisë dhe kriterëve të tjera demografike.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, gjatë periudhës së objektit të auditimit dhe më parë, nuk është mundësuar vetë-deklarimi elektronik i të dhënave të diasporës përmes faqes zyrtare të internetit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës apo platformës së shërbimeve e-Albania. Ky vetë deklarim do të shërbente si një mjet i drejtpërdrejtë komunikimi për ndërtimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave, duke respektuar parimin e vullnetit të lirë të individit, në përputhje me pikën III.2.a të VKM nr. 120, datë 06.03.2024, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Punonjësit e AKD-së kanë shprehur se pasiguria lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale perceptohet si një faktor pengues për mungesën e angazhimit në deklarimin e lirë dhe vullnetar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Diasporës të marrë masa për të mundësuar vetë deklarimin elektronik për shtetasve shqiptarë të diasporës përmes faqes zyrtare web dhe të sigurohet për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim inkurajimin e shtetasve për përditësimin e të dhënave në mënyrë të lirë dhe vullnetare.

Në vijimësi

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT